



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmena • Ombudsperson Institution

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Nga: z.Naim Qelaj, Akokat i Popullit, Institucioni i Avokatit të Popullit

PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE
të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit

Nr.	Komponenta e auditimit (kapitull)	Gjetja	Rekomandimi	Veprimet e planifikuara për tu ndërmarrë	Zyrtari/ët përgjegjës	Data e planifikuara të zbatimit të rekomandimit	Komente
1	Opinion i auditimit	Neni 8 pika 4 e Rregullores Financiare 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo	Avokati i Popullit, duhet të sigurojë që komisionet	Hapi 1	Zyra e Sekretarit	Janar – Dhjetor 2025	Të gjithë komisionet për pranimin e

	<p>Financiare, përcakton se, Zyrtari Kryesor Administrativ me vendim duhet të formojë Komision për Pranimin e Pasurisë jo Financiare, i cili ka përgjegjësi të bëjë verifikimin e sasisë, cilësisë, llojit dhe vlerës e pasurisë jo financiare të pranuar si dhe të dokumentuar me procesverbal e që janë në përputhshmëri me kontratën apo urdheblerjen. Si dhe pika 5 thotë që Komision për Pranimin e Pasurisë jo Financiare duhet të jete në përbërje jo më pak se tre (3) anëtar nga ekspertë të fushës përkatëse duke përfshirë edhe zyrtarin me përgjegjësi material. Anëtar të këtij komisioni në rast nevojë mund të jenë edhe ekspertë të jashtëm. Më tej, specifikat teknike (në kontratës "Renovimi dhe mobilimi i zyrës së pranimit - recepcionit dhe depos për nevojat e IAP-së"), në pozicionin 2,3 kërkohet Furnizim me karrige dhe</p>	<p>përkatësisht për pranimin e mallrave/furnizimev e janë caktuar më kohën dhe se të gjitha pagesat bëhen bazuar në raportet e pranimit nga komisioni përkatës sipas rregullave të përcaktuara.</p>			<p>mallrave/furiz imevenë vitin fiskal 2025, janë caktuar me kohë. Të gjitha pagesat bazohen në raportet e komisionit sipas rregullave të përcaktuar.</p>
--	---	---	--	--	---

	<p>tavolinë) përmasa sipas projektit). Materiali: dru bung, i gdhendur, i lyer dhe mediapan. Ku, pjesa e uljes të karriga duhet të jetë material tekstili me sfungjer, tavolina 100x60x45. Karige 25x25x55, seti nënkupton tavolina dhe tri karrige. Gjatë testimit të pagesave kemi vërejtur se në një rast vlerë 4,029.70 Euro IAP nuk kishte formuar komision të pranimi të mallrave/furnizimeve. Pagesa kishte të bënte me furnizim me mobile. Pasi që Zyrtari Kryesor Administrativ nuk kishte formuar komision të pranimi, mallit ishin pranuar nga menaxheri I kontratës. Më tutje, gjatë ekzaminimit dhe krahasimit të artikujve të pranuar dhe atyre të kontraktuar kemi gjetur se karriget nuk ishin sipas kontratës, pjesa e uljes nuk ishte me material tekstil dhe sfungjer sic ishte e specifikuar në kontratë. Këto çështje kanë të bëjnë me</p>					
--	---	--	--	--	--	--

		kontratën "Renovimi dhe mobilimi i zyrës së pranimit-recepionit dhe depos për nevojat të IAP-së". Kjo ka ndodhur për shkak se Zyrtari Kryesor Administrativ nuk e ka konsideruar të nevojshme formimin e komisionit për pranimin e mallrave/furnizimeve, me arsyetimin se menaxheri i kontratës ka pranuar asistencë nga një zyrtar tjetër i IAP-së.					
2	Opinionimi i auditimit	Sipas nenit 6.1 të rregullores nr.02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare - cdo organizat buxhetore duhet të krijojë dhe azhurojë regjistrin e pasurive jo financiare që i ka në menaxhimin e saj. Me datë 27.09.2021 SP kishte marrë vendim mbi bazën e rekomandimit të komisionit për tjetërsimin e pasurisë nën 1000€, për dhurimin e pasurisë jo financiare të IAP-së, drejtorisë së Arsimit të	Avokati i Popullit duhet të forcojë kontrollet e brendshme në menaxhimin e pasurisë jo financiare, për të siguruar që regjistrat e pasurisë përmbajnë vetëm pasuritë të cilat i kanë në shfytëzim dhe pronësi të saj.	Hapi 1	Zyrtari i logjistikës Zyra e Sekretarit	Maj 2025	E gjithë pasuria jo - financiare e dhuruar me 18.10.2021 sipas pranimi - dorëzimit të pasurisë ka kaluar në sistemin e pasuri të Komunës së Prishtinës.

		<p>Komunës së rishtinës. Më tutje, dorëimi-pranimi i pasurisë në mes të IAP-së dhe drejtorisë së Arsimit në Komunën e Prishtinës ishte bërë me datën 18.10.2021. megjithatë, pasuritë e dhururuara ende figurojnë në regjistrate pasurive jo - financiare të IAP-së. Kjo ceshtje ishte ngritë edhe në raportin e vitit të kaluar. Kjo kishte ndodhë për shkakë të funksionimit jo të mirë të kontrolleve të brendshme dhe mungesës së përgjegjësisë kryerjen e detyrave nga zyrtarët kopetent.</p>					